



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit




Nr 01-400-19468 dt. 11.04 2019

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 6 nënparagrafit 2.1 të Ligjit nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 nënparagrafi 1.1 dhe Rregullores nr.09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit, paraqet këtë kërkesë për miratim:

NISMËN

PER BASHKEPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNEN E LIPJANIT NE FUSHEN E INFRASTRUKTURES DHE FUSHA TJERA

1. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunën e Lipjanit.
2. Qëllimi i bashkëpunimit- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e Infrastrukturës duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushën e Infrastrukturës dhe fusha tjera.
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim – vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës



ARSYETIM

Nismat për vendosjen e bashkëpunimit ndër komunal mund ta marrin organet komunale, institucionet qendrore dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me fushën e vetëqeverisjes lokale.

Komunat hyjnë në bashkëpunim me komunat tjera në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik lokal, të efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit bashkëpunimi komunal ndërkombëtar është kufizuar vetëm në aspektin administrativ dhe teknik.

Komunat e përfshira në cilën do formë të BNK veç e veç dhe bashkërisht mbajnë përgjegjësi juridike për të gjitha veprimet dhe aktet juridike që rezultojnë nga bashkëpunimi në fjalë.

Po ashtu komunat janë të kufizuara të ndërmarrin veprimet për lidhjen e bashkëpunimit ndër komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, në rast se dalim jashtë kompetencave vetanake të përcaktuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës, Çdo bashkëpunim duhet të këtë për qëllim interesin e përbashkët të komunave.

Bashkëpunimi ndër komunal në Republikën e Kosovës edhe normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Bashkëpunim ndër komunal si dhe aktet tjera për zbatimin e këtij ligji.

Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dy apo me shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me parimet, format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin e lartshënuar.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400-19469 dt. 11.04 2019

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 6 nënparagrafit 2.1 të Ligjit nr.04/L-010 për Bashkëpunim Nder komunal dhe nenit 5 nënparagrafi 1.1 dhe Rregullores nr.09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Nder komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-010 për bashkëpunim ndër komunal, Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2019 të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM


Për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal

I. Me këtë Propozim Vendim, kërkohet që të miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Drenasit për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.

II. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunën e Lipjanit.

III. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal.

IV. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës së Drenasit.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Bashkëpunimi ndër komunal në Republikën e Kosovës edhe normuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Bashkëpunim ndër komunal si dhe aktet tjera për zbatimin e këtij ligji.

Për realizimin e qëllimeve dhe interesave të përbashkëta lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre vetanake sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dy apo me shumë komuna kanë të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi në pajtim me parimet, format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin e lartshënuar.

Pra komunat hyjnë në bashkëpunim me komunat tjera në funksion të zhvillimit më të shpejtë ekonomik lokal, të efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit, bashkëpunimi komunal ndërkombëtar është kufizuar vetëm në aspektin administrativ dhe teknik.

Me respekt!